

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL
Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit
Financiar për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2016

Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse- sipas natyrës.....	2
Pasqyra ndryshimeve në aktivet neto për mbajtësit e kuotave.....	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
1. Informacione të përgjithshme	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	5
3. Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara	9
4. Standardet dhe interpretimet e reja	10
5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve	11
6. Rreziqet financiare	12
7. Paraqitja me vlerë të drejtë.....	18
8. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	19
9. Investime në letra me vlerë	19
10. Të ardhurat nga interesi prej investimeve në letrat me vlerë	21
11. Të ardhura të tjera nga interesi	21
12. Angazhime dhe detyrime të konstatuara	22
13. Transaksionet me palët e lidhura	22
14. Ngjarje pas datës së raportimit.....	22



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Këshillit të Administrimit të Fondit të Pensionit Vullnetar Sigal

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Fondit të Pensionit Vullnetar Sigal ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto të mbajtësve të kuotave në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse,

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, kati 9, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al



Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
31 maj 2017
Tiranë, Shqipëri

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"*(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e pozicionit financiar**

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
AKTIVE			
Investime në letra me vlerë	9	645,779,458	422,176,657
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	8	28,598,591	46,295,406
TOTALI AKTIVIT		674,378,049	468,472,063
DETYRIME			
Detyrime të tjera		(1,687,891)	-
TOTALI I DETYRIMEVE		(1,687,891)	-
VLERA NETO E AKTIVEVE		672,690,158	468,472,063
Gjendja e numrit të kuotave të fondit		518,677.8642	376,885.5539
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT		1,296.9325	1,243.0088

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese të Fondit, Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a., më 15 maj 2017 dhe janë firmosur nga:


Naim Hasa
Drejtor i Përgjithshëm




Junida Zavalani
Specialiste Finance

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse – sipas natyrës**

	Shënime	2016	2015
Të ardhura nga interesa të investimeve	10	40,321,147	27,808,556
Të ardhura të tjera nga interesa	11	122,690	236,052
		40,443,837	28,044,608
Shpenzime për tarifë komisioni		(16,804,094)	(11,417,685)
Humbje neto nga kursi I këmbimit		(64,656)	(18,803)
Rritja ne aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave nga operacionet		23,575,087	16,608,120

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra ndryshimeve në aktivet neto për mbajtësit e kuotave**

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitimet neto nga investimet	23,575,087	16,608,120
Rritja neto në aktivet neto nga operacionet e biznesit të fondit	23,575,087	16,608,120
Flukset hyrëse nga anëtarët e fondit	192,802,376	149,882,833
Flukset dalëse prej ndryshimit të fondit të pensionit	(11,183,651)	(7,653,007)
Flukset dalëse prej pagesave të pensionit apo tërheqjeve të parakohshme	(975,716)	(924,140)
Rritje neto në aktivet neto nga transaksionet me anëtarët e fondit	180,643,009	141,305,686
Rritja totale në aktivet neto	204,218,096	157,913,806
AKTIVET NETO		
Në fillim të periudhës	468,472,063	310,558,257
Në fund të periudhës	672,690,159	468,472,063
Numri i kuotave në fillim të periudhës/në datën e aprovimit të licencës	376,886	260,928
Kuota të pensionit të emtuara mbi bazën e hyrjeve të kontributeve	151,344	123,061
Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të fondit të pensionit	(769)	(4,019)
Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e pagesave të pensionit ose tërheqjeve të parakohshme	(8,783)	(3,084)
NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT NË FUND TË PERIUDHËS	518,678	376,886

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"*(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e Flukseve të Parasë**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operacional		
Rritja e vlerës së aktiveve neto	23,575,087	16,608,120
Rregullime për :		
Ndryshime në të ardhura të përlogaritura nga investimi në letra me vlerë	(4,006,642)	(3,982,905)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>		
Hyrje nga kontribute të anëtarëve	192,802,376	149,882,833
Flukset dalëse prej ndryshimit të fondit të pensionit	(11,183,651)	(7,653,007)
Flukset dalëse prej pagesave të pensionit apo tërheqjeve të parakohshme	(975,716)	(924,140)
Ndryshim në të arkëtueshme nga shoqëria administruese	1,687,891	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale	201,899,345	153,930,901
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti investues		
Letra me vlerë të maturuara	9 13,300,000	
Blerje letra me vlerë	9 (232,896,160)	(140,000,000)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investues	(219,596,160)	(140,000,000)
Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	(17,696,815)	13,930,901
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	46,295,406	32,364,505
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës	8 28,598,591	46,295,406

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal ("Fondi") është një fond kontributësh i aprovuar për të operuar si I tillë, sipas vendimit nr. 51, datë 30 Mars 2011 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF").

Objekti i Fondit është të gjenerojë rritje afatmesme dhe afatgjatë të rëndësishme të kapitalit dhe ka si synim të arrijë këtë objektiv duke tregtuar një portofol të letrave me vlerë qeveritare të qeverisë shqiptare.

Fondi është nën administrimin e "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a." ("Shoqëria Administruese"), liçensuar nga AMF më 30 Mars 2011.

Fondi i pensionit bashkë-zotërohet nga të gjithë kontribuesit e fondit, nën një bashkëpronësi të ndarë, që përfaqësohet në kuota të fondit të pensionit. Çdo kuotë përfaqëson pronësinë proporcionale mbi aktivet e fondit të pensionit.

Autoriteti Shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare caktoi dhe aprovoi Tirana Bank sh.a. si Depozitar të Fondit të Pensionit. Shoqëria Administruese dhe Depozitari kërkohet të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e Fondit të Pensionit prej aktiveve, veprimeve dhe regjistrimeve të tyre. Për këtë arsye regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit dhe Shoqërisë Administruese mbahen të ndara dhe pasqyrat financiare respektive përgatiten gjithashtu të ndara. (Shënimi 4)

Adresa e regjistruar

Zyra qendrore e Shoqërisë Administruese është në: Bulevardin "Zogu I" Rr.nr.1, Tiranë, Shqipëri.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Fondit të Pensionit Sigal janë përgatitur mbi një bazë vijimësie dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas parimit të kostos historike. Politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të dhëna më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e prezantuara, përveçse kur është shprehur ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël të caktuara. Gjithashtu kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël. Në ato raste ku përfshihet një nivel më i lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose rastet kur ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë dhënë në Shënimin 3.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e shoqërisë. Monedha funksionale e Shoqërisë është monedha në mjedisin primar ekonomik në të cilin ajo operon.

Transaksionet dhe balancat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e përgatitjes së pasqyrës së pozicionit financiar.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i kursit të këmbimit valutor janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet që lidhen me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre nga këmbimi valutor janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave brenda zërit 'fitimet neto në monedhë të huaj apo humbjet në mjete monetare dhe ekuivalente të tyre.

Fitimet dhe humbjet që lidhen me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse brenda zërit të "ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes."

Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Fondit maten me koston e amortizuar në varësi të kategorisë së tyre të matjes.

i) Njohja

Instrumentet financiare të Fondit (aktivet dhe detyrimet) njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus koston e transaksionit. Vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare evidentohet më mirë nëpërmjet çmimit të transaksionit. Një fitim ose humbje në momentin fillestar do të njihet vetëm nëse ka ndonjë diferencë ndërmjet vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të vëzhgueshme në treg për të njëjtin instrument ose nëpërmjet një teknike vlerësimi inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshëm.

ii) Klasifikimi

Aktivitetet financiare ndahen në kategoritë e mëposhtme: (a) hua dhe të arkëtueshme (depozita me afat në banka dhe sigurime të arkëtueshme) dhe (b) aktive financiare të mbajtura deri në maturim (MDM). Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime të tjera financiare (duke përfshirë detyrime të sigurimit/tregtare dhe detyrime të tjera) dhe shpërndahen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe njihen me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua dhe të arkëtueshme janë aktive financiare jo derivative dhe të pakuotuar me pagesa fikse ose të përcaktueshme, përveç atyre që Fondi ka synim të shesë në një afat të afërt. Hua-të dhe të arkëtueshmet përfshijnë depozitat me afat me bankat dhe sigurime dhe të tjera të arkëtueshme dhe njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke i zbritur provizionet për humbjet e ndodhura nga zhvlerësimi.

Aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturim përfshijnë aktive financiare të pakuotuar, jo derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe maturitete fikse, për të cilat Fondi ka synimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Menaxhimi përcakton klasifikimin e letrave me vlerë të sigurimit të mbajtura deri në maturim gjatë njohjes fillestare dhe rivlerëson përshtatshmërinë e këtij klasifikimi në fund të çdo periudhe raportimi. Investimet të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke i zbritur provizionet për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

iii) Çregjistrimi

Fondi çregjistron një aktiv financiar kur: (a) mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur (b) të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha përfitimet së aktivitetit financiar ose hyn në një marrëveshje kualifikuese ndërkohë që (i) gjithashtu transferon në mënyrë të rëndësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet të pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon as mban në mënyrë të rëndësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por as duke mbajtur kontroll. Kontrolli mbahet kur kundërpala nuk ka aftësitë praktike për të shitur aktivin në tërësi ndaj një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojën të vendosë kufizime të mëtejshme për shitjen. Fondi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

iv) *Matja e kostos së amortizuar*

Kosto e amortizuar është vlera me të cilën aktivi financiar është njohur në momentin fillestar duke zbritur çdo ripagesë principali, plus interesin e përlogaritur dhe për aktivet financiare duke zbritur çdo zhvlerësim për humbje të ndodhura. Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në momentin e njohjes fillestare dhe të çdo primi apo skontimi të vlerës deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat e përlogaritura dhe shpenzimet e përlogaritura të interesit, duke përfshirë dhe kuponin e përlogaritur dhe skontimin ose primin e amortizuar (duke përfshirë tarifat e shtyra që në krijim, nëse ka), nuk paraqiten të ndara dhe janë të përfshira në vlerën kontabël të zërave të lidhur në pasqyrën e pozicionit financiar.

v) *Netimi*

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka një të drejtë të detyrueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një qëllim ose për të shlyer mbi një bazë neto, ose për të realizuar aktivin dhe shlyer detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme, si ato në aktivitetin tregues të Fondit.

vi) *Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbartura me koston e amortizuar*

Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje kur kanë ndodhur si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarje me humbje") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar të cilat kanë ndikim në shumën apo kohën e flukseve të ardhshme të çmuara të aktivitetit financiar ose grup aktivesh financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Shoqëria përcakton se nuk ka evidencë objektive që ekziston zhvlerësimi për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë, dhe vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre. Faktorët kryesorë që Shoqëria konsideron në përcaktimin nëse një aktiv financiar është zhvlerësuar janë statusi i kalimit të afatit, detyrimet që mund të netohen për të njëjtin klient dhe realizueshmërinë e kolateralit përkatës, nëse ka. Kriteret e mëposhtme janë përdorur gjithashtu për të përcaktuar nëse ka një evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi ka ndodhur kur :

- Ndonjë pjesë ose kësti i ka kaluar afati dhe pagesa të vonuara nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes;
- pala tjetër ka një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informatat e saj financiare që Shoqëria merr;
- pala tjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim financiar;
- ka ndryshim negativ në statusin e pagesave të palës tjetër si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë palën tjetër; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, në mënyrë të konsiderueshme zvogëlohet si rezultat i përkeqësimit të kushteve të tregut.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investimet e tjera afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Depozitat me afat maturimi më shumë se tre muaj klasifikohen si depozita me afat me bankat, si një nën-kategori të kredive dhe të aktiveve financiare të arkëtueshme

Entiteti investues dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumtë të papërfshirë me të dhe mban investime të shumta. Fondi është konsiderohet si një entitet i cili përmbush përkufizimin e një entiteti investues sipas SNRF 10 sepse kushtet e mëposhtme ekzistojnë:

(a) Fondi ka siguruar fonde për qëllim të sigurimit të investitorëve me shërbime profesionale të menaxhimit të investimit.

(b) Qëllimi i biznesit të fondit, që iu është komunikuar drejtpërdrejtë investitorëve, është të investojë për vlerësimin e kapitalit dhe të ardhurat nga investimi.

(c) Investimet maten dhe vlerësohen mbi bazën e vlerës së drejtë (përveç atyre të klasifikuara si investime të mbajtura deri në maturim.

Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen si ato të cilat kanë një afat maturimi më të madh se 3 muaj. Interesi llogaritet në bazë rrjedhëse duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

Investime në letra me vlerë

Letrat me vlerë janë tituj borxhi të cilët Fondi ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe klasifikohen si aktive për tu mbajtur deri në maturim. Investimet , të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat janë me qëllim për t'u mbajtur në maturim maten me kosto të amortizuar, minus parashikimin për zhvlerësim në vlerë Kosto e amortizuar është përlllogaritur duke marrë në llogari ndonjë zbritje apo prim në blerje. Primi dhe zbritja e investimeve të mbajtura deri në maturim amortizohen në mënyrë sistematike deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe regjistrohen në të ardhura nga interesat.

Vlera neto e aktiveve

Aktivet neto përfaqësojnë kontribute monetare dhe kthimin nga investimi të këtyre kontributeve mbas zbritjes së tarifave dhe komisioneve për Shoqërinë Administruese, e zotëruar nga kontribuuesit e fondit të pensionit.

Në përputhje me nenin 12, nr. 10198 të datës 12 Dhjetor 2009 "Mbi fondet vullnetare të pensionit", Shoqëria Administruese konverton në kuota kontributet e investuara në Fond. Çdo kuota përfaqëson një pjesë proporcionale të pronësisë mbi çdo aktiv të Fondit.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SIGAL”

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

Të ardhurat nga interesa në letra me vlerë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet apo primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose çregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Fondit.

Shpenzimet e tarifës së administrimit

Në përputhje me nenin 69, Ligji nr. 10197, datë 12 Dhjetor 2009 mbi : “ Fondet vullnetare të pensionit”, Fondi ka si detyrim të paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë vjetore menaxhimi prej 3% të vlerës së Aktiveve Neto. Ky përfaqëson një shpenzim për fondin dhe llogaritet mbi bazë ditore.

3. Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bënë efektive për Shoqërinë nga 1 janar 2016:

- SNRF 14, Llogaritë e shtyra (publikuar në janar 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Kontabiliteti për blerjen e interesave në operacione të përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018) .
- Bujqësi: Bimët prodhuese - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 gusht 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Ndryshimet e SNK 1 në sajë të projektit për shënimet shpjeguese (publikuar në dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2016) .
- Njësi ekonomike investuese: Aplikimi i ndryshimit mbi përjashtimin e konsolidimit në lidhje me SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore për ose pas 1 janar 2016).

Standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë dukshëm pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. Standardet dhe interpretimet e reja

Standarde të caktuara të reja dhe interpretime janë lëshuar që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë me 1 janar 2017 ose më vonë, dhe që shoqëria nuk ka miratuar më herët.

SNRF 9, "Instrumentet financiare" (publikuar në korrik 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018). Pikat kryesore të standardit janë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura më pas me kosto të amortizueshme, aktive të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe ato të matura më pas me vlerën e drejte nëpërmjet fitimit dhe humbjes.
- Klasifikimi i instrumenteve të huasë bazohet tek modeli i biznesit të njësisë në menaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktit nëse flukset monetare kontraktuale rrjedhin kryesisht nga pagesat e interesit dhe të kryegjësë. Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të kryegjësë dhe interesave. Instrumentet e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes.
- Aktivet financiare që nuk përmbajnë pagesa për interesa apo kryegjë duhet të maten me vlerën e drejtë në fitim apo humbje (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshira nuk janë më të ndara nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të kryegjësë dhe interesave.
- Investimet në instrumente të kapitalit maten gjithmonë me vlerë të drejtë. Sidoqoftë, drejtimi i shoqërisë mund zgjedhë të paraqesë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti të mos mbahet për qëllime tregtimi. Nëse instrumenti i kapitalit mbahet për qëllime tregtimi, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në pasqyrën e fitim humbjes.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësia duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.
- SNRF 9 prezanton një model të ri të njohjes së humbjeve së zhvlerësimit – modelin e humbjeve të pritura kreditore. Ka një qasje me tre faza e cila bazohet në ndryshimin e cilësisë kreditore të aktivit financiar që nga njohja.
- Në praktikë, rregullat e reja parashikojnë që njësitë duhet të njohin një humbje të drejtpërdrejtë të barabartë me humbjet e pritura kreditore për 12 muaj në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk preken nga zhvlerësimi kreditor (apo modeli i përhershëm i humbjeve të pritura kreditore për llogaritë e arkëtueshme). Kur ka një rritje domethënëse në rrezikun kreditor, zhvlerësimi matet me modelin e përhershëm në vend të modelit 12 mujor. Ky model përfshin lehtësira operacionale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme.
- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë rishikuar për një përshtatje më të mirë ndërmjet kontabilitetit dhe menaxhimit të rrezikut. Standardi i jep njësive mundësi zgjedhje midis zbatimit të kërkesave të kontabilitetit të mbrojtës të SNRF 9 dhe zbatimit të SNK 39 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin mbrojtës në nivel makro.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. Standardet dhe interpretimet e reja (vazhdim)

Shoqëria nuk pritet të ketë një ndikim material nga standardi i ri në lidhje me klasifikimin dhe matjen. Kontabiliteti mbrotjës nuk ndikon në pasqyrat financiare individuale të shoqërisë, pasi shoqëria nuk kryen transaksione të tilla.

Standardet e reja ose të ndryshuara nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë.

- SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).
- Projektit për shënimet shpjeguese – Ndryshime në SNK 7 (publikuar në 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017).
- Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date për t'u përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit).
- Njohja e aktivitetit të tatimit të shtyrë për humbje të përealizuara – Ndryshime në SNK 12 (publikuar në 19 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017).
- Ndryshime në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar në 12 prill 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).
- Ndryshime në SNRF 2, Pagesa të bazuara në aksione (publikuar në 20 qershor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).
- Ndryshime në SNRF 4, Kontratat e sigurimit (publikuar në 12 Shtator 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Fondi bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorët e tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Rreziqet financiare

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një varieteti të rreziqeve financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikut të vlerës së drejtë të normës së interesit, rrezikut të fluksit monetar të normës së interesit dhe rrezikut të çmimit), rrezikun e kredisë dhe rrezikut të likuiditetit.

Fondi është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve operacionale të tilla si rreziku i ruajtjes së aktiveve. Rreziku i rrezikut i ruajtjes së aktiveve kujdestarisë është rreziku i humbjes së letrave me vlerë që ruhen, shkaktuar nga falimentimi ose neglizhenca e kujdestarit. Edhe pse ekziston një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga kujdestari, në rast të dështimit të saj, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të mos jetë e vlefshme përkohësisht.

Programi i përgjithshëm i Fondit të menaxhimit të rrezikut kërkon të maksimizojë kthimet e rrjedhura për nivelin e rrezikut për të cilat Fondi është i ekspozuar dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të Fondit.

Funksioni i administrimit të rrezikut në kuadër të Fondit kryhet në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operacionale dhe rreziqet ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e çmimeve të tjera), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Objektivat kryesore të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas të sigurohet se ekspozimi ndaj rreziqeve qëndron brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacionale dhe ligjore kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore. Fondi nuk shfrytëzon instrumente financiare derivative për të mbrojtur ekspozimet e këtyre rreziqeve.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Rreziqet financiare (vazhdim)

Kuadri i menaxhimit të rrezikut

Aktiviteti i Fondit monitorohet dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA. Sh.a ("Shoqëria Administruese") në bazë të ligjit nr. 10197, datë 10 Dhjetor 2009 mbi "Fondet Vullnetare të Pensionit", Shoqëria Administruese duhet të ketë një funksion të veçantë dedikuar menaxhimit të rrezikut.

Aksionarët e Shoqërisë Administruese caktuan Këshillin Administrativ, i cili përbëhet nga pesë anëtarë:

- Z. Adrian Totokoçi, Kryetar
- Z. Klement Mersini, Anëtar
- Z. Naim Hasa, Anëtar
- Z. Abdyl Sarja, Anëtar
- Z. Edvin Hoxhaj, Anëtar

Kompetencat e Këshillit Administrative përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi implementimin e politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administrative ; aprovimin e politikave financiare dhe investuese; caktimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimit. Këshilli Administrativ është i përkushtuar në sigurimin që veprimet e Shoqërisë Administruese janë në përputhje me standardet ligjore dhe të kontabilitetit.

Këshilli Administrativ caktoi anëtarët e Komitetit Investues si më poshtë:

- Z. Naim Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese.
- Z. Klement Mersini, Drejtori Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Z. Blodin Cuci, Përgjegjës i Zyrës së Strategjisë dhe Analizës, Banka e Shqipërisë
- Znj. Esmeralda Shehaj, Pedagogje e Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik dhe Konsulente për investimet dhe menaxhimin e rrezikut.

Komiteti i Investimit organizon jo më pak se katër mbledhje në vit, në mënyrë që të zhvillojë politika investimi, të kryejë shpërndarjen dhe modifikimin e aktiveve dhe t'ia paraqesë ato Shoqërisë Administruese. Këto politika mbështeten mbi analiza sasiore dhe cilësore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të riksut dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufijtë maksimum të investimit të përcaktuar nga ligji dhe rregulloret e përmendura më lart.

Depozitari

Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.10197, e datës 10 Dhjetor 2009 "Për Fondet Vullnetare të Pensionit", aktivet e Fondit të Pensioneve, duke përfshirë mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre, do të mbahen në një depozitar të vetëm, e cila duhet të jetë një bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të kujdestarisë dhe të miratuar nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare për rolin depozitues.

Shoqëria Administruese e Fondit ka marrëveshje me Tirana Bank sh.a. .Banka në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10 Dhjetor 2009 mbi " Fondet Vullnetare të Pensionit" do të sigurojnë shërbime lidhur me kujdestarinë, depozitat dhe besueshmëri për aktivet e fondit.

Funksioni i Depozitarit përfshin llogaritjen e vlerës neto të fondit të pensionit dhe raportimin në bazë mujore ndaj Shoqërisë Administruese, duke u siguruar se të ardhurat nga transaksionet që përfshijnë aktivet nga fondi i pensionit shpërndahen/kapitalizohen ndaj kontribuuesve të fondit të pensionit në

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Rreziqet financiare (vazhdim)

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe informon Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi çdo çështje që mund të përbëjë një shkelje të legjislacionit ose kërcënim të interesave të anëtarëve.

Tirana Bank është degë e Bankës Piraeus, Greqi e cila është vlerësuar me C nga S&P me një perspektivë të qëndrueshme.

6.1 Rreziku i tregut

Fondi është i ekspozuar ndaj rrezikut të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga ekspozimi ndaj tregjeve të rrezikut. Rreziqet e tregut vijnë nga pozicionet e hapura në: (a) valutë të huaja, (b) aktive interes-mbajtëse dhe detyrime dhe (c) produkte të kapitalit, ku të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, që monitorohet mbi një bazë ditore. Megjithatë përdorimi i kësaj përqsaje nuk i parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëritë ndaj rreziqeve të tregut të përfshira më poshtë bazohen në ndryshimin e një faktori duke mbajtur faktorët e tjerë të pandryshuar. Në praktikë kjo ka shumë pak mundësi të ndodhë dhe ndryshimet në disa prej faktorëve mund të jenë të korreluar për shembull ndryshimet në normat e interesit dhe ndryshimet në kurset e këmbimit.

a) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Rreziku i kursit të këmbimit, lind sepse vlera e transaksioneve të ardhshme, aktiveve monetare të njohura dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedha të tjera luhatet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. Megjithatë menaxhimi monitoron ekspozimin e të gjithë aktiveve dhe detyrimeve të shprehura në monedhë të huaj.

Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare sipas Bankës Qendrore (Lek për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishin si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
USD	128.17	125.79
Euro	135.23	137.28

Ekspozimi ndaj kursit të këmbimit përmban rrezikun e lëvizjeve të pafavorshme në kurset e këmbimit të valutave. Aktivët dhe detyrimet financiare në valutë të huaj më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

31 Dhjetor 2016

Aktive	në Lek	në EUR	Totali
Mjete monetare në arkë dhe bankë	24,727,693	3,870,898	28,598,591
Investime në letra me vlerë	645,779,458	-	645,779,458
Totali i aktiveve financiare	670,507,151	3,870,898	674,378,049
Totali i detyrimeve financiare	(1,687,891)	-	(1,687,891)
Pozicioni neto	668,819,260	3,870,898	672,690,158

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Rreziqet financiare (vazhdim)

6.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

31 Dhjetor 2015

Aktive	në Lek	në EUR	Totali
Mjete monetare në arkë dhe bankë	45,854,051	441,355	46,295,406
Investime në letra me vlerë	422,176,657	-	422,176,657
Totali i aktiveve financiare	468,030,708	441,355	468,472,063
Totali i detyrimeve financiare	-	-	-
Pozicioni neto	468,030,708	441,355	468,472,063

b) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe të flukseve të mjeteve monetare. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar kushtëzon se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 Fondi nuk ka detyrime të rëndësishme të interesit dhe për këtë arsye nuk ka përqendrim të konsiderueshëm të rrezikut të normës së interesit.

Çmimet e bonove dhe normat e interesit janë të lidhura në mënyrë indirekte. Në anën tjetër një mjedis me norma të ulëta interesi e bën sfidues për Fondin për të siguruar një normë kthimi të brendshme, të përshtatshme.

Një zhvendosje paralele në kurbën e yield-it nga 100bp për portofolin e letrave me vlerë me të ardhura të Shoqërisë ka një ndikim neto me Fitim/Humbje prej 6,772,819 Lekë (2015: 4,684,721 Lekë)

6.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi nuk do të përmbushë obligimet e tij që lidhen me detyrimet financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Fondi është i ekspozuar ndaj kësteve mujore të pagesave periodike të pensionit dhe pagesave për tërheqjet e parakohshme nga fondi i pensionit. Politika e Shoqërisë Administruese është të investojë pjesën më të madhe të aktiveve të saj në investime që janë të tregtueshme në tregjet aktive dhe mund të shiten lehtësisht. Për tërheqjet e parakohshme nga Fondi, Shoqëria e Administrimit vendos limite kohore për njoftimin e tërheqjes nga fondi, si për shembull 30 ditë.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2016
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Rreziqet financiare (vazhdim)

6.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 jepet më poshtë:

31 Dhjetor 2016	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale					Më shumë se 5 vjet
		Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj – 1 vit	1 - 5 vjet		
Aktive financiare							
Mjete monetare dhe ekuivalente	28,598,591	28,598,591	-	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	645,779,458	942,956,900	6,160,385	32,734,765	442,025,350	453,565,650	
Totali i aktiveve	674,378,049	971,555,491	6,160,385	32,734,765	442,025,350	453,565,650	
Detyrime financiare							
Hendeku i maturitetit neto	(1,687,891)	(1,687,891)	-	-	-	-	-
Efektivi kumulativ	672,690,158	969,867,600	6,160,385	32,734,765	442,025,350	453,565,650	
			41,541,835	74,276,600	516,301,950	969,867,600	
31 Dhjetor 2015							
Aktive financiare							
Mjete monetare dhe ekuivalente	46,295,406	46,295,406	36,400,000	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	422,176,657	637,133,045	4,143,235	27,121,135	117,882,980	485,542,320	
Totali i aktiveve financiare	468,472,063	683,428,451	40,543,235	27,121,135	117,882,980	485,542,320	
Detyrime financiare							
Hendeku i maturitetit neto	468,472,063	683,428,451	40,543,235	27,121,135	117,882,980	485,542,320	
Efektivi kumulativ			52,882,016	80,003,151	197,886,131	683,428,451	

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2015

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Rreziku financiar (vazhdim)

6.3 Rreziku i kredisë

Emetuesit e instrumenteve të borxhit të përfshira në portofolin mund të mos arrijnë të paguajnë interesat dhe principalin. Përkeqësimi në cilësinë e kredisë gjithashtu nënkupton rënie të vlerës së tregut dhe likuiditetit për instrumentin themelor. Një rritje në marzhin e kredisë mund të ulë vlerën e tregut të instrumenteve të borxhit që çon në një rënie të përgjithshme në vlerën neto të aktiveve për fondin.

Alokimi strategjik i aktiveve është në përputhje me rregulloren për "Aktive të lejueshme, kufizime në sasinë maksimale të investimeve në fondet e pensione", të datës 18 tetor 2010 dhe përmban vetëm instrumente të borxhit të lëshuara nga Departamenti i Thesarit të Qeverisë Shqiptare.

Ekspozimi maksimal i Fondit ndaj rrezikut të kredisë sipas klasës së aktiveve është reflektuar në vlerat kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar si vijon:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre (duke përfshirë paratë në arkë)	28,598,591	46,295,406
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	645,779,458	422,176,657
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë	674,378,049	468,472,063

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë vendosur në Bankën Tirana (Depozitari), të vlerësuar C me perspektivë të qëndrueshme nga S&P në nivel të kompanisë mëmë (Piraeus Bank SA) pasi nuk është vlerësuar veçmas

Strategjia e investimit

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit të Pensionit Vullnetar Sigal mbështetet në ligjin nr. 10197 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" dhe rregulloret e publikuara në zbatim të tij nga AMF si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë Administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese.

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit të Pensionit Vullnetar Sigal – "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA", i përmbahet ligjit nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar", si dhe rregullores "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit", miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr. 1, datë 28 janar 2010 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit nr.109, datë 18 tetor 2010.

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- Bono thesari, obligacione dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- Bono thesari, obligacione dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
- Bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- Depozita bankare në banka të licënuara, me afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- Letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më lart, sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më lart sipas Moody's ose BBB (e ulët) ose më lart sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);

Aksione ose kuota të fondeve të investimit të licënuara në një shtet anëtar të BE-së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

7. Paraqitja me vlerë të drejtë

Vlerat e drejta të letrave me vlerë që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv përcaktohen duke përdorur teknika vlerësimi, kryesisht të ardhurat shumëfishë, flukset e mjeteve monetare të skontuara dhe transaksioneve të kohëve të fundit të krahasueshme .

Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta janë të vlefshme dhe të rishikohen periodikisht nga Shoqëria Administruese. Inputet në modele me të ardhurat e shumëfishta përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme , siç janë shumëfisha të të ardhurave të kompanive të krahasueshme me kompaninë përkatëse të portofolit , dhe të dhëna të pavëzhgueshme, të tilla si të ardhurat e parashikuara për kompaninë portofolit. Në modelet e skontuara të flukseve monetare, inputet jo të vëzhgueshme janë flukset e mjeteve monetare të projektuara të kompanisë përkatëse portofolit dhe primit të rrezikut për likuiditet dhe rrezikun e kreditit që janë të përfshira në normën e skontimit . Megjithatë, normat e skontimit e përdorur për vlerësimin e letrave me vlerë të kapitalit përcaktohen në bazë të kthimeve kapitale historike për subjektet e tjera që veprojnë në të njëjtën industri për të cilat kthimet e tregut janë dukshme. Menaxhimi përdor modele për të rregulluar kthimin e kapitalit neto të vëzhguar për të reflektuar strukturën aktuale të financimit të borxhit / kapitalit neto të investimeve të vlerësuara të kapitalit. Modelet janë të kalibruar nga mbropa- testimit për rezultatet aktuale/ çmimet e daljes të arritura për të siguruar që rezultatet janë të besueshme.

Fondi klasifikohet, për qëllime të shpalosjes, matjet e vlerës së drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementeve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet).

Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e kuotuar të shitësit. Për instrumentet financiare që nuk tregtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe që nuk kanë transparencë në çmime, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme të gjykimit, në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve mbi çmimet dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë në instrument.

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre përfshijnë paranë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat rezidente. Sikurse këto gjendje janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën e mbartur.

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet në letrat me vlerë janë mbajtur me vlerën e drejtë.

Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2015
(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Paraqitje me vlerë të drejtë (vazhdim)

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje te vlerës së drejtë periodike.

	Të mbajtura deri ne maturim	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale kontabël	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2016				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	28,598,591	-	28,598,591
Investime në letra me vlerë	645,779,458	-	645,779,458	645,779,458
31 Dhjetor 2015				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	46,295,406	-	46,295,406
Investime në letra me vlerë	422,176,657	-	422,176,657	422,176,657

8. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjete monetare në arkë	-	-
Mjete monetare në bankë	28,598,591	46,295,406
<i>Në valutë të huaj</i>	24,727,693	45,854,051
<i>Në Lek</i>	3,870,898	441,355
Totali	28,598,591	46,295,406

Mjete monetare në bankë në Lek përfshin depozita afatshkurtër për periudha që variojnë ndërmjet 1 dite dhe 3 muajsh, në varësi të kërkesave të menjëhershme të Shoqërisë dhe të cilat fitojnë interes sipas normave përkatëse afatshkurtra të interesit:

9. Investime në letra me vlerë

Bono Thesari	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Çmimi i blerjes	635,500,000	413,000,000
Zbritje	(2,935,565)	-
Prim	31,724	-
Interesa të përlogaritur	13,183,299	9,176,657
Totali	645,779,458	422,176,657

Investime në bono thesari shqiptare të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim, arritën vlerën 645,779,458 Lek me afat maturimi prej rreth 5.26 vjet dhe interesat që variojnë nga 4.89% deri 9.52% në vit (2015: 422,176,657 Lek, me afat maturimi 6.76 vjet dhe interesat variojnë nga 6.45% deri në 9.52% në vit)

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2015

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

9. Investime në letra me vlerë (vazhdim)

Bono thesari

31 Dhjetor 2016

Data e blerjes	Data e maturimit	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Norma e interes në kupon	Kosto e amortizuar më 31 dhjetor 2016
08.02.2013	08.02.2018	5,400,000	5,400,000	8.89%	5,591,944
18.03.2013	18.03.2020	19,000,000	19,000,000	9.52%	19,520,353
07.05.2013	07.05.2018	21,700,000	21,700,000	8.45%	21,978,158
13.06.2013	13.06.2020	13,000,000	13,000,000	9.12%	13,063,873
09.08.2013	09.08.2018	26,400,000	26,400,000	7.70%	27,208,365
12.12.2013	12.12.2018	5,600,000	5,600,000	6.60%	5,620,785
16.12.2013	16.12.2020	36,900,000	36,900,000	7.45%	37,024,989
24.01.2014	24.01.2024	10,000,000	10,000,000	9.25%	10,407,296
17.03.2014	17.03.2021	12,500,000	12,500,000	7.64%	12,777,655
25.04.2014	25.04.2024	7,700,000	7,700,000	9.34%	7,832,088
08.05.2014	08.05.2019	9,500,000	9,500,000	6.65%	9,594,248
16.06.2014	16.06.2021	8,000,000	8,000,000	7.67%	8,027,965
13.08.2014	13.08.2019	14,100,000	14,100,000	6.62%	14,460,707
15.09.2014	15.09.2021	8,700,000	8,700,000	7.77%	8,900,242
24.10.2014	24.10.2024	26,700,000	26,700,000	9.25%	27,160,287
10.11.2014	10.11.2019	6,000,000	6,000,000	6.62%	6,056,991
09.12.2014	09.12.2021	6,500,000	6,500,000	7.85%	6,532,949
23.01.2015	23.01.2025	32,200,000	32,200,000	9.25%	33,519,833
05.05.2015	04.05.2020	10,000,000	10,000,000	6.45%	10,103,165
16.06.2015	16.06.2022	19,800,000	19,800,000	7.80%	19,870,459
24.07.2015	24.07.2025	67,500,000	67,500,000	8.90%	70,145,153
16.09.2015	16.09.2022	18,000,000	18,000,000	7.78%	18,410,928
23.10.2015	23.10.2025	14,500,000	14,500,000	8.80%	14,741,418
08.11.2016	08.11.2021	40,000,000	40,000,000	5.25%	40,307,726
16.03.2016	16.03.2023	500,000	531,724	4.9%	531,512
15.09.2016	15.09.2023	22,000,000	22,000,000	4.89%	22,319,061
18.01.2016	18.01.2026	65,500,000	65,500,000	7.9%	67,864,772
15.07.2016	15.07.2026	32,000,000	32,000,000	5.8%	32,863,186
07.10.2016	07.10.2026	15,800,000	15,800,000	6.7%	16,048,231
15.09.2016	15.09.2023	60,000,000	57,064,435	4.89%	57,295,119
		635,500,000	632,596,159		645,779,458

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2015

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

9. Investime në letra me vlerë (vazhdim)

31 Dhjetor 2015

Data e blerjes	Data e maturimit	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Norma e interest në kupon	Kosto e amortizuar më 31 dhjetor 2015
07.01.2013	07.01.2016	11,500,000	11,500,000	8.55%	11,972,506
08.02.2013	08.02.2018	5,400,000	5,400,000	8.89%	5,589,357
18.03.2013	18.03.2020	19,000,000	19,000,000	9.52%	19,512,493
08.04.2013	08.04.2016	1,800,000	1,800,000	8.18%	1,833,538
07.05.2013	07.05.2018	21,700,000	21,700,000	8.45%	21,969,954
13.06.2013	13.06.2020	13,000,000	13,000,000	9.12%	13,055,987
09.08.2013	09.08.2018	26,400,000	26,400,000	7.70%	27,196,180
12.12.2013	12.12.2018	5,600,000	5,600,000	6.60%	5,618,480
16.12.2013	16.12.2020	36,900,000	36,900,000	7.45%	37,006,908
24.01.2014	24.01.2024	10,000,000	10,000,000	9.25%	10,400,833
17.03.2014	17.03.2021	12,500,000	12,500,000	7.64%	12,773,236
25.04.2014	25.04.2024	7,700,000	7,700,000	9.34%	7,829,852
08.05.2014	08.05.2019	9,500,000	9,500,000	6.65%	9,591,253
16.06.2014	16.06.2021	8,000,000	8,000,000	7.67%	8,023,862
13.08.2014	13.08.2019	14,100,000	14,100,000	6.62%	14,455,218
15.09.2014	15.09.2021	8,700,000	8,700,000	7.77%	8,897,164
24.10.2014	24.10.2024	26,700,000	26,700,000	9.25%	27,160,267
10.11.2014	10.11.2019	6,000,000	6,000,000	6.62%	6,055,167
09.12.2014	09.12.2021	6,500,000	6,500,000	7.85%	6,529,765
23.01.2015	23.01.2025	32,200,000	32,200,000	9.25%	33,498,957
05.05.2015	04.05.2020	10,000,000	10,000,000	6.45%	10,100,333
16.06.2015	16.06.2022	19,800,000	19,800,000	7.80%	19,860,060
24.07.2015	24.07.2025	67,500,000	67,500,000	8.90%	70,103,250
16.09.2015	16.09.2022	18,000,000	18,000,000	7.78%	18,404,560
23.10.2015	23.10.2025	14,500,000	14,500,000	8.80%	14,737,477
		413,000,000	413,000,000		422,176,657

10. Të ardhurat nga interesi prej investimeve në letrat me vlerë

	2016	2015
Të ardhura nga bonot e thesarit	40,321,147	27,808,556
Totali	40,321,147	27,808,556

11. Të ardhura të tjera nga interesi

	2016	2015
Të ardhura nga interesi prej depozitave afat shkurtër	122,690	236,052
Totali	122,690	236,052

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2015

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

12. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

Detyrime të konstatuara Ligjore Në kursin normal të biznesit Shoqëria merr pretendime ligjore të cilat nuk i përkasin biznesit kryesor. Drejtimi i Shoqërisë ka opinionin që nuk do të ndodhin humbje materiale në pozicionin financiar të Fondit, apo ndryshim në aktivet neto, përveçse për ato të cilat një provizion është përfshirë tashmë në këto pasqyra financiare.

13. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra prej tyre ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë influencë të konsiderueshme ndaj tjetrës në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo kur palët janë nën kontrollin e përbashkët të Shoqërisë.

Një numër transaksionesh me palët e lidhura janë ndërmarrë gjatë kursit normal të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive paraqiten si më poshtë:

<i>Vlera Neto e Aktiveve nga kontribute të punëdhënësit</i>	2016	2015
Sigal Uniqa Group Austria sh.a.	59,316,896	50,293,396
Avel sh.p.k (entitet në pronësi të aksionarëve të shoqërisë administruese dhe administruar nga kryetari i këshillit të administratës së Fondit)	3,593,500	3,034,500
Tarifat e menaxhimit të paguara ndaj Shoqërisë së Administrimit		
Sh.a.f.p. Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.		
-Paguara	15,116,203	11,417,685
-Detyrim	1,687,891	-

14. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat mund të kërkohej korrigjim apo shënime sqaruese në pasqyrat financiare.